

**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“GLOBAL MINING” shpk**

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

Bazuar ne ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 i ndryshuar si dhe akteve nenligjore ne fuqi “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

U vendos si me poshte:

**Neni 1:  
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 20 SHKURT 2023 themeluesi shoqeria “GREEN MINERALS” SH.P.K, e rregjistruar prane Qendres Kombetare te Bizneseve Tirane me daten 31 Janar 2023, me NIPT M38731601V sipas vendimit te asamblese se ortakeve nr 1, date 20 Shkurt 2023 ka vendlor te krijoje një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “GLOBAL MINING” SH.P.K. (“Shoqeria”).

Themeluesi i Shoqërisë eshte shoqeria “GREEN MINERALS” SH.P.K. ne cilesine e ortakut te vetem.

**Neni 2:  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Ne fushen e kerkim-zbulimit, nxerrjes dhe shfrytezimit, perpunimit dhe tregtimit, eksport-importit te gjitha minraleve metalore dhe jo metalore e te tjera.
- Ne fushen e transportit te minraleve dhe mallrave te ndryshem brenda dhe jashtë vendit, per vete dhe per te trete.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- Shoqëria e ka selinë në: Rezidencen banese private tre kateshe, me nr. pasurie 11/00 ne Fshatin Vlad Njesia Administrative Bytyc Rrethi Tropoje Qarku Kukes Shqiperi.
- Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njeqind mijë) Lekë ne para dhe është i ndarë në 1 (Nje) kuote. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - “GREEN MINERALS” SH P K ortak i vetem, zoterues i nje kuote qe perfaqeson 100 perqind te kapitalit te Shoqerise.

**Neni 6:  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

*Faqe 1 e 8  
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
GLOBAL MINING shpk*



- 2) Zmadhim i dhe zvogëlimi i kapitalit vendoset nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rruge trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve/ ortakut te vetem është organi i me i larte vendimmarrës i Shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve/ortakut te vetem është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprintarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprintarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

**Neni 9**  
**Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme**

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Faqe 2 e 8  
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
GLOBAL MINING shpk



**Neni 10  
Kuorumi**

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 11  
Marrja e vendimeve**

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e Shoqërisë.

**Neni 12  
Përashtimi nga e drejta e votës**

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


**Neni 13  
Administrimi**

- 1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Administratori i pare i Shoqërisë emërohet **Besart Riza Dushi** atësia Riza, shtetas shqiptar identifikuar me anë të pasaportës me numër **BF0567604** me numër personal identifikimi **J20527097E** i datëlindjes **27-05-1992** lindur ne **Bajram Curri** dhe banues ne **Bajram Curri, rrethi Tropoje**.
- 2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 3) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**Neni 14  
Kompetencat e Administratorëve**

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

*Faqe 3 e 8  
Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
GLOBAL MINING shpk*



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Kur nuk parashikohet ndryshe ne aktin e emerimit, nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht Shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbilimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajtje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrate të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 3 e 4 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbuje Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrate të tyre në mënyrë të përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

*Faqe 4 e 8*  
**Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**GLOBAL MINING shpk**

- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**KREU IV  
VITI FINANCIAR, AUDITORI**

**Neni 16  
Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

**Neni 17  
Auditori i Shoqerise**

- 1) Nese emerohet, auditori i Shoqerise kryen detyrat sipas ligjit ne fuqi.

**KREU V  
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18  
Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me ligjin.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket/ortaku nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19  
Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

**Faqe 5 e 8**

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
GLOBAL MINING shpk

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet gjykates kompetente.

**ORTAKU I VETEM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"GLOBAL MINING "**

Mehmet Muja  
GREEN MINERALS SHPK  
Perfaqesuar nga administratori Z. Mehmet Muja



**Faqe 6 e 8**  
**Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**GLOBAL MINING shpk**